

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SHBA ndërhyt në mbështetje të Elon Musk për anulimin e gjobës 120 milionë euro ndaj X nga BE-ja
ADRESA	https://albeu.com/teknologji/shba-nderhyn-ne-mbeshtetje-te-elon-musk-per-anulimin-e-gjobes-120-milione-euro-ndaj-x-nga-be-ja/1027439/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:20:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:18:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6c27a43bc02793931d929ecf10c3966b20bef72b3aba620d16ac30fbe952914a
TEKSTI	dc552749f7e61a3e84a301c1a71e64229f9d9e114ab801728e2b7e5582086712
PAMJA	e2dafa3ed4cd15079ed958818855ac32401d1079bdfb358226f9866285e45153

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2813162dfd035caca9a06d83fa5a3957475475ced474082446949aa070421aad
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2813162dfd035caca9a06d83fa5a3957475475ced474082446949aa070421aad>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SHBA ndërhyt në mbështetje të Elon Musk për anulimin e gjobës 120 milionë euro ndaj X nga BE-ja



Departamenti amerikan i Drejtësisë ka kërkuar të përfshihet në betejën ligjore të Elon Musk dhe platformës X kundër gjobës prej 120 milionë eurosh, ose 105 milionë paundësh, të vendosur nga Bashkimi Evropian për përdorimin e shenjave blu të verifikimit.

Kërkesa është depozituar në Gjykatën e Përgjithshme të BE-së, ku SHBA-ja synon të mbështesë përpjekjet e Musk dhe X për rrëzimin e vendimit të Komisionit Evropian.

Sipas DOJ-së, Statuti i Gjykatës së Drejtësisë së BE-së lejon ndërhyrjen e një shteti në një çështje gjyqësore kur ai mund të dëshmojë se ka "interes në rezultatin e çështjes".

Departamenti amerikan argumenton se Uashingtoni "ka një interes të qartë" për të garantuar që vendimet e Komisionit të merren dhe zbatohen në përputhje me "mënyrën se si juridiksioni territorial kuptohet përgjithësisht në të drejtën ndërkombëtare".

Gjithashtu, SHBA-ja kërkon që vendimi të mos dëmtojë në asnjë formë shërbimet dixhitale me seli në Amerikë, të cilat, sipas saj, "kontribuojnë ndjeshëm" në ekonominë amerikane.

Të enjten, ndihmësprokurori i përgjithshëm amerikan Brett A. Shumate akuzoi Komisionin Evropian se kishte "tentuar në mënyrë të papërshtatshme" të zgjeronte juridiksionin e vet mbi kompani amerikane që ndodhen jashtë kontrollit të tij.

Gjobën, e njoftuar në dhjetor 2025, Komisioni Evropian e lidhi me mënyrën se si X përdor shenjat blu. Sipas tij, platforma "i mashtron përdoruesit" duke u dhënë mundësi personave të paguajnë për verifikimin, pa "verifikuar në mënyrë kuptimplotë" identitetin e mbajtësit të llogarisë.

të fundit /



SHBA ndërhyt në mbështetje të Elon Musk për anulimin e...



FOTO/ Ivanka Trump shkëlqen në darkën shtetërore për Xi...



Krasniqi beson te fitorja e Kosovës edhe në transfertën ndaj...



Nis mbledhja e Këshillit Drejtues të PDK-së



Afati deri më 6 tetor, presioni mbi partitë: marrëveshje për...



Rast shqetësues në një shkollë në Itali: 6-vjeçarit i zbulohet në...



Rama në Nju Jork: Shqipëria po krijon imunitet ndaj...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Rregullatorët evropianë e akuzuan gjithashtu X për mungesë transparence rreth reklamave dhe për pengimin e studiuesve që kërkonin akses në të dhëna publike.

Kur u vendos gjoka, Henna Virkkunen, nënkryetarja ekzekutive e Komisionit përgjegjëse për sovranitetin teknologjik, tha se institucioni po "e mbante X përgjegjës për cenimin e të drejtave të përdoruesve dhe shmangien e përgjegjësisë".

"Mashtrimi i përdoruesve me shenjat blu të verifikimit, fshehja e informacionit mbi reklamat dhe përjashtimi i studiuesve nuk kanë vend në hapësirën online të BE-së", u shpreh ajo.

Musk, i cili shpenzoi miliona dollarë për të ndihmuar në zgjedhjen e Donald Trumpit dhe republikanëve të tjerë, ka deklaruar më herët se rregullat evropiane për teknologjinë "pengojnë përparimin" e kompanive.

Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, si dhe Komisioni Federal i Komunikimeve, FCC, e kanë kritikuar rregullatorin evropian, duke e akuzuar për sulm dhe censurim të kompanive amerikane.

"Gjoka e Komisionit Evropian nuk është thjesht një sulm ndaj X; është një sulm ndaj të gjitha platformave amerikane të teknologjisë dhe popullit amerikan nga qeveritë e huaja", shkroi Rubio në një postim në X.

Ai shtoi: "Ditët e censurimit të amerikanëve online kanë përfunduar."

Musk e ripostoi deklaratën e Rubios dhe e shoqëroi me komentin: "Absolutisht."

Komisioni Evropian ka mohuar se po synon një kombësi të caktuar, duke thënë se po mbron standardet e veta digjitale dhe demokratike, ndërsa synon të ruajë rolin e BE-së si pikë referimi globale.

Ky ishte vendimi i parë zyrtar i Komisionit për mospërputhje me rregullat në kuadër të Aktit të Shërbimeve Digjitale, DSA-së, një prej dy paketave të detyrueshme që rregullojnë platformat online në Bashkimin Evropian.

Ndërkohë, BE-ja po kryen edhe hetime të tjera ndaj X. Mes tyre është edhe një procedurë për asistentin e integruar me inteligjencë artificiale, Grok, për shkak të shqetësimeve se ai është përdorur për krijimin e imazheve të seksualizuara të personave realë.

/BBC/

Shtuar më 25.09.2026 17:18





© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj

Free Esim

Zgjedhjet 2025

Belinda Balluku

SPAK

Kombëtarja

Kategori

Lifestyle

Showbiz

Tech

Shëndetësi

Argetim

Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare

Moti në Shqipëri

Travel

Horoskopi

Livescore

News from Albania

Tags

Edi Rama

Albania News

Ilir Meta

Piranjat

gazeta, tv, portale

Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë

Moti në Prishtinë

Moti në Shkup

Moti në Durrës

Moti në Prizren

Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi

Kushtet e Përdorimit

Privacy Policy

Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.